



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Agjencia e Kosovës për Akreditim  
Agencija Kosova za Akreditaciju  
Kosovo Accreditation Agency



Ref.: 1084/24 Datë: 30/05/2024

Në mbështetje të nenit 11 të Ligjit nr. 08/l-110 për Agjencinë e Kosovës për Akreditim (GZ.nr. 13 / 29 qershor 2023, Prishtinë, nenit 7 të Ligjit për Arsimin e Lartë në Republikën e Kosovës Nr. 04/L-037 (GZ, Nr.14/9 Shtator 2011), nenit 8 dhe 14 të Ligjit për Organizimin dhe Funkcionimin e Administratën Shtetërore dhe të Agjencive të Pavarura të Republikës së Kosovës Nr.06/L-113 (GZ.Nr.07/01 mars 2019), Ligjit për Procedurën e Përgjithshëm Administrative Nr.05/L-031 (GZ.Nr.20/12 Qershor 2016), Udhëzimin Administrativ për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës (Nr.15/2018, datë 28.09.2018), Rregulloren e Punës së Këshillit Shtetëror të Cilësisë, si dhe referuar procesverbalit të mbledhjes së 123-të, mbajtur me datë 20.05.2024, Këshilli Shtetëror i Cilësisë, mori:

### V E N D I M

- I. Riakreditohet programi i studimit i Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës për periudhën tre (3) vjeçare, (1 tetor 2024 – 30 shtator 2027):
  1. *Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike BSc 180 ECTS, me kuotën maksimumi 250 studentë për vit akademik;*
  2. *Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike MSc 120 ECTS, me kuotën maksimumi 50 studentë për vit akademik;*
- II. Numri i studentëve si në paragrafin I, zbatohet për secilin vit të studimit për periudhën e akreditimit.
- III. Obligohet Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës që deri më datë 15.11.2024 të dorëzoj në Agjencinë e Kosovës për Akreditim (tutje AKA) Planin e Implementimit të Rekomandimeve të dhëna nga ekspertët ndërkombëtar të akreditimit.
- IV. Obligohet Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës të raportojë dhe arsyetojë çdo ndryshim në listën e bartësve të programeve të studimit në AKA, brenda 90 ditëve. Ndryshimi i bartësve bëhet vetëm me vendim nga KShC.
- V. AKA rezervon të drejtën e aplikimit të dispozitave të nenit 21 të Udhëzimit Administrativ Nr.15/2018 për Akreditimin e Institucioneve të Arsimit të Lartë në Republikën e Kosovës, kurdo që vlerëson të arsyeshme dhe të nevojshme.
- VI. Institucioni i Arsimit të Lartë si në paragrafin I mban përgjegjësi ligjore për çdo moszbatim apo tejkallim të këtij vendimi.
- VII. Ky vendim hyn në fuqi me nënshkrimin e tij.

## ARSYETIM

Fakulteti i Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës brenda afatit ligjor ka parashtruar kërkesë në Agjencinë e Kosovës për Akreditim, për riakreditimin e programeve të studimit me stafin akademik si në tabelë:

Nr.	Programi i studimit	Bartësit e programit
1.	<i>Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike BSc 180 R</i>	Avni Rexhepi Valon Raça Qefsere Doko Gjonbalaj
2.	<i>Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike MSc 120 R</i>	Isak Shabani Artan Mazrekaj

Me qëllim të vlerësimit të programeve të studimit, AKA ka organizuar vizitat me ekspertë ndërkombëtarë të akreditimit në Fakultetin e Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës.

Bazuar në nenin 17 të UA Nr.15/2018 për akreditimin e IAL-ve, ekipi i vlerësuesve të jashtëm (Ekspertët ndërkombëtar) ka hartuar raportet e vlerësimit për secilin program, dhe për fushat e standardeve të akreditimit të parapara në Manualin e Akreditimit ka dhënë konstatimet si në vijim:

- Për programin e studimit; *Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike BSc 180 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Seifedine Kadry, Anastasios Dagiuklas, Flavio Canavero, Stefania Armaselu, Damian Michalik dhe Asnate Upmace, është organizuar më 26.03.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), ndërsa Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve.
- Për programin e studimit; *Inxhinieri Kompjuterike dhe Softuerike MSc 120 ECTS***, vizita me ekspertët ndërkombëtar të akreditimit me këtë përbërje: Seifedine Kadry, Anastasios Dagiuklas, Flavio Canavero, Stefania Armaselu, Damian Michalik dhe Asnate Upmace, është organizuar më 26.03.2024 ku nga shtatë fushat e standardeve të akreditimit, ky program është vlerësuar se i përmbush: Plotësisht dy (2), ndërsa Substancialisht pesë (5) fusha të standardeve.

Këshilli Shtetëror i Cilësisë, në mbledhjen e 123-të, të mbajtur më datë 20.05.2024, ka shqyrtuar dokumentacionin e Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike në Universitetin e Prishtinës dhe duke u bazuar në raportet e ekspertëve ndërkombëtarë të akreditimit gjatë realizimit të vizitave si dhe rekomandimet përfundimtare të dhëna në raportet finale të vlerësimit nga ekspertët e cekur më sipër, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

**Këshillë juridike:** *Kundër këtij vendimi pala e pakënaqur mund të paraqet ankesë në Komisionin e ankesave, në afatin prej tridhjetë (30) ditësh nga dita kur pala është njoftuar për aktin administrativ. Ankesa adresohet përmes organit publik që ka nxjerrë aktin.*

Vendimi iu dërgohet:

- Fakultetit të Inxhinierisë Mekanike dhe Kompjuterike në UP;
- MASHTI;
- Arkivit të AKA-së,

  
 Prof. Asoc. Dr. Hasnija Ilazi  
 Kryetare e Këshillit Shtetëror të Cilësisë